



**Përgjigje pyetjeve në lidhje me të drejtat e kërkuësve dhe përfituesve të mbrojtjes ndërkombëtare.**

**1. Si azilkërkuës në Greqi keni të drejtat e mëposhtme:**

- i. Ju paiseni me kartën e kërkuësit të mbrojtjes ndërkombëtare me të cilën mund të qarkulloni në mënyrë të ligjshme në vend.
- ii. Keni të drejtën e hyrjes në kujdesin mjekësor dhe farmaceutik falas.
- iii. Fëmijët tuaj mund të shkojnë në shkollë.
- iv. Keni të drejtën e strehimit me kushtet që përmenden më poshtë.
- v. Keni të drejtën të punoni me kushte të përcaktuara.

**2. Parashikohet e drejtë për strehim?**

Azilkërkuësit në përputhje me dekretin presidencial (d.p.)220/2007 kanë të drejtë për strehim. Kompetente është Ministria e Punës. Shërbimi i Azilit është kompetent që të transmetojë kërkesën e azilkërkuësve për strehë tek autoriteti kompetent, Qendra Kombëtare e Solidaritetit Shoqëror, që i përket Ministrisë së Punës. Megjithëse kërkuësit kanë të drejtë në strehë në këtë moment ekzistojnë afërsisht 1000 vende në strukturat e pritjes me rezultat pamundësinë e realizimit të kërkesave përkatëse. Refugjatët e njohur dhe përfituesit e mbrojtjes plotësuese nuk kanë të drejtën për strehë sipas legjislaturës së Europës së Bashkuar për azilin.

**3. Mundet shteti të na gjejë punë?**

Megjithëse azilkërkuësit dhe përfituesit e mbrojtjes ndërkombëtare kanë të drejtën të punojnë, shteti nuk mund tju sigurojë vend pune, ashtu si nuk mundet dhe për shtetasit Grekë.

**4. Çfarë të drejtash domethënë do të kemi nëse do të na jepet mbrojtje ndërkombëtare (status refugjati ose mbrojtje plotësuese) në Greqi?**

- i. Do tju lëshohet leje qëndrimi falas me afat trevjeçar e cila mund të rinovohet. Kjo leje do tju dorëzohet 1-2 muaj pas dorëzimit të vendimit tuaj pozitiv. Deri atëherë do të keni në

duart tuaja kartën e kërkuesit të mbrojtjes ndërkombëtare me shënimin<<Në Pritje të Lejes së Qëndrimit>>

ii. Do tju lëshohen dokumente udhëtimi pas kërkesës suaj për të cilat do të paguani depozitën prej 85 euro.Nëse keni marrë mbrojtje plotësuese (jo status refugjati) dhe keni ose mundeni të nxirrni pashaportë nga autoritetet e vendit tuaj,nuk nxirrni dokumenta udhëtimi,derisa mundeni të udhëtoni me pashaportën tuaj.

iii. Do të keni të drejtën të punoni.

iv. Do të keni të drejtën e hyrjes në kujdesin mjekësor.

v. Fëmijët tuaj mund të shkojnë në shkollë.

vi. Ndërkaq,Shteti nuk ofron strehë ,as nuk mundet të sigurojë të drejtën për të punuar,as tju ofrojë ndonjë ndihmë asistence,përveç asistencës së paafitit për ata që kanë ndonjë formë invaliditeti.

#### **5. Pasi është marrë vendimi me të cilin më jepet mbrojtje ndërkombëtare(status refugjati ose mbrojtje plotësuese).cila procedurë duhet të ndiqet që të marr leje qëndrimi dhe dokumenta udhëtimi?**

Pasi të merrni vendimin nga Shërbimi ynë,duhet të shkoni tek shërbimi kompetent i Policisë Greke(për Athinën në Adresën e të Huajve në rrugën Πέτρου Ράλλη 24) që të depozitoni dokumentat që nevoiten për lëshimin e lejes suaj të qëndrimit.Për 1-1,5 muaj pas depozitimit të dokumentacionit përkatës,do të duhet të vini ne Shërbimin e Azilit që ta merrni atë. Paralelisht mund të bëni dhe kërkesën për lëshimin e dokumentave të udhëtimit.Të dy proceset mund të kryhen njëkohësisht.

#### **6. Të rriturit mund të shkojnë në shkollë?Ku do të mësojmë greqisht?**

Të rriturit kanë të drejtën e hyrjes në arsim nën disa kushte.Herë pas here Shoqëria ofron mësim për mësimin e gjuhës greke.Do të njoftoheni në lidhje me këtë,me njoftime të Shërbimit të Azilit,por dhe nga shoqatat dhe organizatat jo qeveritare të cilat aktivizohen në këtë fushë.

#### **7. Mund të udhëtojmë në pjesën tjetër të Europës?**

I vetmi rast të udhëtojë një azilkërkues në mënyrë te ligjshme në një shtet tjetër europian është nëpërmjet procedurës së Rregullores së Dublinit III,në kuadrin e bashkimit familjar.Si azilkërkues nuk mund të udhëtoni në pjesën tjetër te Europës, përveç nëse ekzistojnë arsye të rëndësishme të vërtetuara shëndeti që detyrojnë transportimin tuaj jashtë shtetit.

Në se ju jepet status refugjati ose mbrojtje plotësuese mund të bëni kërkesë që tju jepen dokumenta udhëtimi.Përfundimi i procedurës së paisjes me dokumenta udhëtimi mund të zgjasë 1-2 muaj.Me dokumentat e udhëtimit që do tju jepen keni të drejtën të udhëtoni në shtete të tjera europiane por jo të vendoseni në to. Mund të qëndroni në to për 3 muaj çdo 6 muaj por pas fundit të 3 mujorit duhet të largoheni. Që të vendoseni në një vend tjetër europian duhet të plotësoni kushtet që vendos secili shtet europian për shtetasit e vendeve të treta.

#### **8. Mundet përfituesi i mbrojtjes ndërkombëtare(refugjat ose përfitues i mbrojtjes plotësuese) me dokumentat e udhëtimit të udhëtojnë jashtë Europës së Bashkuar?**

Mundet por duhet ti lëshohet leje hyrje (vizë) nga ambasada ose konsullata e shtetit të cilin dëshiron të vizitohet,nëse dicka e tillë parashikohet.Duhet ti drejtoheni ambasadës ose konsullatës së shtetit që dëshironi të vizitoni për informacion.

#### **9. Me cilin mund të bashkohemi në kuadrin e procedurës Dublin?**

Mund të bashkohen të miturit e pashoqëruar me prindërit e tyre,vëllezërit e motrat e tyre,me xhaxhallarë, daja ,teze, halla,dhe me gjyshër e gjyshe.

Bashkëshortët mes tyre.

Prindërit me fëmijët e tyre të mitur .

Të rriturit(p.sh. vëllezer të rritur,prindër me fëmijë te rritur) mund të bashkohen vetëm si përjashtime,kur p.sh. ekziston një problem i rëndësishëm shëndeti,dikush është i moshuar dhe ka nevojë për kujdesin e të afërmit, etj.

#### **10. Çfarë dokumentash duhet të kemi për procedurën e Dublinit?**

Do të duhet të keni me vehte dokumenta që vërtetojnë që pjesëtari i familjes suaj ndodhet në një shtet tjetër europian si azilkërkuar ose si përfitues i mbrojtjes ndërkombëtare(refugjat ose përfitues i mbrojtjes plotësuese).Çdo dokument që keni, i cili vërteton lidhjen tuaj familjare mirë është ta dorëzoni.

#### **11. Në se na jepet statusi i refugjatit si mundemi të sjellim këtu familjen tonë(nga një vend jashtë Europës së Bashkuar)?**

Përfituesit e statusit të refugjatit kanë te drejtën e bashkimit familjar me pjesëtarë të familjes së tyre që ndodhen në vendin e prejardhjes(bashkëshort-e,fëmijë të mitur).Do të duhet të dorëzoni tek Shërbimi një kërkesë përkatëse.Kjo procedurë është mjaft e gjatë dhe

burokratike pasi përfshihen dhe shërbime të tjera si Ministria e Jashtme,dhe nuk mund te vlerësohet sa do të zgjasë.

**12. Do të duhet të kemi shtëpi dhe punë që të sjellim pjesëtarët e familjes sonë në Greqi?**

Nëse do të dorëzoni kërkesën për bashkim familjar brenda 3 muajve nga dhënia e statusit të refugjatit nuk është e nevojshme të plotësoni të tilla kushte.

**13. Çfarë dokumentash nevoiten dhe çfarë procedure ndiqet?**

i. Çertifikatë familjare e tashme ose dokument tjetër i përkthyer zyrtarisht në greqisht dhe i çertifikuar nga autoriteti kompetent grek, nga i cili të duket lidhja familjare e personave për ardhje,me refugjatin,si dhe moshat e tyre.

ii. Kopje e saktë me origjinalin të dokumentave të udhëtimit të pjesëtarit ose të pjesëtarëve të familjes.

iii. (Nëse refugjati nuk mundet të dorëzojë dokumentat e mësipërme, autoritetet kompetente të dorëzimit dhe të shqyrtimit të azilit marrin për bazë të dhëna të tjera vërtetuese.Vendim refuzues nuk mund të themelohet vetëm në mosekzistencën e këtyre dokumenteve.)

iv. Pasi të aprovohet kërkesa nga Shërbimet e Azilit do të duhet konsullata e Greqisë të lëshojë lejen e hyrjes(vizë) qe të udhëtojë i afërmi juaj në Greqi.

v. Pashaportë ose dokument tjetër udhëtimi i njohur nga vendi ynë me afat kohor i cili duhet te tejkalojë me tre muaj datën e skadimit te vizës.

vi. Dëshmi penaliteti të Autoriteteve të huaja me të cilën çertifikohet gjendja penale e kërkuesit.Në rastet që ekziston vendim përfundimtar gjykimi, me arsye që krijojnë rrezik për rendin publik dhe sigurinë,kërkohe arsyetim i vecantë dhe peshohen secili nga parametrat si pesha e shkeljes,ripërsëritja dhe në thelb sjellja e paligjshme e shtetasit te vendit të tretë.

vii. Vërtetim mjekësor nga institucion i njohur shtetëror ose privat nga i cili të rezultojë që nuk vuan nga sëmundje e aftë për të shkaktuar rrezik për shëndetin publik,në përputhje me të dhënat ndërkombëtare dhe të Organizatës Ndërkombëtare të Shëndetit,gjithashtu dhe nga sëmundje infektuese,ngjitëse,ose parazite të cilat detyrojnë marrjen e masave për mbrojtjen e shëndetit publik.

**14. Me lejen e qëndrimit që na jepni mund të udhëtojmë në Europë?**

Jo .Ju nevoiten dhe dokumenta udhëtimi.

**15. Dikush që është njohur si refugjat mund të udhëtojë jashtë Greqisë për arsye të rëndësishme dhe urgjente para se të lëshohen dokumentat e tij të udhëtimit?**

Jo.Por në rast se vërtetohet që ekzistojnë arsye urgjente humanitare ndoshta mund të shpejtohet procedura.

**16. Sa kohë duhet për lëshimin e dokumentave të udhëtimit nga çasti që përfituesi bën kërkesën dhe ka përgjigje pozitive?**

Afërsisht 1-1,5 muaj

**17. Për të marrë shtetësinë greke ,çfarë duhet?**

Kushtet parashikohen në Kodin e Shtetësisë Greke,Në mënyrë të përmbledhur për rastin tuaj duhet:

- i. Të jeni i rritur(**mbi 18 vjet**).
- ii. Të mos jeni dënuar përfundimisht për shkelje të caktuara që parashikohen nga neni 5 i Kodit të Shtetësisë Greke.
- iii. Të jeni **njohur** si refugjat ose si përfitues i mbrojtjes plotësuese ose të jeni pjesëtar i familjes së refugjatit ose e përfituesit të mbrojtjes plotësuese **dhe të keni lejen perkatëse të qëndrimit**.
- iv. Të qëndroni në Greqi në mënyrë të ligjshme **për tre vjet të vazhdueshëm nëse jeni njohur si refugjat ose për 7 vjet të vazhdueshëm nëse jeni përfitues i mbrojtjes plotësuese**.
- v. Të njihni mjaftueshëm **gjuhën Greke**.
- vi. Të jeni integruar normalisht në jetën ekonomike dhe shoqërore të Vendit dhe të keni mundësinë të merrni pjesë aktivisht dhe thelbësisht në jetën politike të Vendit,në përputhje me kriteret që vendos neni 5 i Kodit të Shtetësisë Greke..

**18. Sa zgjat leja e qëndrimit dhe sa dokumentet e udhëtimit?**

Afati i lejes së qëndrimit është tre vjet.Leja e Qëndrimit rinovohet pas kërkesës suaj.Dokumentat e udhëtimit kanë afat pesë vjet.

**19. Në rast se kemi prind ose vëlla/motër që jetojnë jashtë Europës së Bashkuar të cilët jetonin me ne dhe vareshin nga ne para se të largoheshim dhe nuk kanë dikë që të kujdeset për ta,bëhet bashkim familjar dhe si?**

Si përjashtim mund të bëhet bashkim familjar i refugjatit të rritur me prindin e tij.Vec të mësipërmeve që u përmenden në lidhje me bashkimin familjar duhet të dorëzoni gjithashtu:

i) vërtetim të autoritetit publik të siguracionit shoqëror,me të cilin vërtetohet që refugjati ka siguracion të plotë për rreziqet në total që parashikohen për kategoritë përkatëse të punësuarve të huaj,i cili të mbulojë dhe pjesëtarët e familjes së tij që do të mbahen prej tij/saj

ii) Dokument përkatës nga autoriteti i taksimit ose çdo dokument tjetër publik nga i cili të vërtetohet që disponon të ardhura vjetore të qëndrueshme e të rregullta,të mjaftueshme për nevojat vetiake dhe të familjes së tij,të cilat nuk vinë nga sistemi i asistencës sociale së Vendit.Këto të ardhura nuk mund të jenë me të vogla se pagesat vjetore të një punëtori të pakualifikuar,plus 20% per bashkëshorten dhe plus 15% per çdo prind dhe fëmijë.

iii) Kontratë e çertifikuar e blerjes së banesës,ose kontratë e marrjes me qera të banesës, çertifikuar nga shërbim shtetëror ekonomik ose dokument tjetër i çertifikuar që të vërtetojë që refugjati zotëron strehë ku mund të mbulojë nevojat e tij dhe të familjes së tij.Me vëllezërit/motrat tuaj nuk mund të bashkoheni.

**20. Cilat janë veprimet e paligjshme që mund të na përjashtojnë nga statusi i refugjatit ose të përfituesit të mbrojtjes plotësuese ose të çojnë në anullimin e tij nëse na është dhënë?**

Veprimet e mëposhtme mund të sjellin përjashtimin ose anullimin e statusit të mbrojtjes ndërkombëtare(status refugjati ose i mbrojtjes plotësuese):Krim ose krim i lehtë që dënohet me burgim te paktën tre vjet si dhe padrejtesitë e dëmtimit të rëndë fizik (kodi penal 310),i rrëmbimit të të miturve(kodi penal 324),i grabitjes me dhunë(kodi penal 327),sulm i dinjitetit seksual(kodi penal 337 paragrafi 2-5),i joshjes së të miturve(kodi penal 339),shfrytëzimit dhe masturbimi mbi të miturit(kodi penal 342),pornografisë së të miturve(kodi penal 348A),tërheqjes së fëmijve për arsye seksuale(kodi penal 348B),prostitucioni,shfrytëzimi i prostitutës,masturbim mbi të miturin me pagesë,kërcënim(kodi penal 385).

**21. Mund të japim dorëheqjen nga mbrojtja ndërkombëtare(azil ose mbrojtje plotësuese) në çdo çast që dëshirojmë?**

Nga procedura e azilit mund të jepni dorëheqjen kur të dëshironi. Gjithashtu, mund të jepni dorëheqjen dhe nga statusi i refugjatit dhe nga statusi i mbrojtjes plotësuese, nëse ju është dhënë. Kjo do të thotë që pas dorëheqjes suaj do të duhet të largoheni nga Greqia, përndryshe do të ndodheni në mënyrë të paligjshme në vend dhe në rast se do të doni të bëni përsëri kërkesë për azil, kjo kërkesë e dytë mund të pranohet me shumë vështirësi.